

## **Propozimet për Projekt Ligjin e Arsimit të Lartë.**

Në mbledhjen e datës 29.01.2015, Këshilli i Institutit të Fizikës Bërthamore, mori në shqyrtim Projekt Ligjin e Arsimit të Lartë në RSH për të bërë vërejtjet e mundshme.

Nga diskutimet e bëra konkludua në këto vërejtje:

### **I**

#### **Në Nenin 27, Instituti kërkimor-shkencor, pika 2 thuhet:**

“Instituti organizohet në së paku dy qendra kërkimore-shkencore dhe jo më shumë se një departament.”

**Nuk na duket bindëse ideja:**

- 1. E ekzistences së vetem një departamenti në një Institut sepse në Nenin 28, Departamenti, thuhet se:**

“Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore, i cili përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive.”

**Pra brenda departamentit duhet të ketë fusha kërkimi homogjene dhe brenda një Instituti nuk mund të ketë vetëm një fushë kërkimi.**

- 2. E ekzistencës së njëkohshme të departamentit dhe qendrës në të njëjtin Institut, ndërkohe që midis departamentit dhe qendrës nuk shohim ndonjë dallim rrënjësor në menyrën e organizimit dhe funksionimit.**

**Kjo ilustron në Nenin 29, Qendra kërkimore-shkencore:**

1. Qendra kërkimore-shkencore e Fakultetit/Institutit ka strukturë të ngjashme me departamentin dhe kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
2. Qendra mund të marrë pjesë në realizimin e programeve të studimeve master i shkencave dhe doktoratë të ofruara nga njësi kryesore përkatëse.
3. Qendra ka në përbërje të saj të paktën **7 anëtarë**, të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët **tre duhet të kenë grada shkencore ose tituj akademikë. Personeli akademik i qendrës zgjedh drejtuesin e saj.**
4. Rregulla të tjera mbi strukturën dhe funksionimin e qendrës përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

Nuk dallohen ndryshime ndermjet departamenteve dhe qendrave.  
Ose ndoshta nuk dalin te qarta keshtu sic eshte shkruar ligji.

## II

**Ne Nenin 48, Drejtuesi i njësisë bazë, pika 3, thuhet “Kandidati për drejtues vetëkandidohet dhe është personel akademik i njësisë bazë përkatëse. Në rastet kur nuk ka kandidatë që mbajnë Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” drejtuesi mund të mbajë dhe gradën shkencore “Doktor”.**

Mendojmë që i jepet prioritet Profesorit ose As. Profesorit. Jemi në kushtet kur ka mungesë personeli sidomos në institucionet kërkimore-shkencore. Për shkak të daljes në pension të personelit me tituj të lartë shkencorë, kjo mungese do te thellohet më shumë me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

## III

**Në Nenin 64, Fitimi i titujve akademikë, pika 1, thuhet “Për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore “Doktor”, përmbush standardet shtetërore dhe ka fituar statusin “Lektor” prej së paku pesë vjetësh. Për fitimin e titullit “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin “Profesor i asociuar” si dhe përmbush standardet shtetërore të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”**

1. Perse duhet vënë kriteri taksativ i statusit “Lektor” për marrjen e titullit As. Prof. ndërkohe që këto dy statuse nuk i dallon asgje nga njëri tjetri, veç një kërkesë për ta marrë statusin Lektor kur ke Graden Doktor?.
2. Marrja e statusit Lektor nuk ka qënë kusht me ligjin ekzistues dhe konsiderohej i barasvlefshëm me ate Doktor. Pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, personelit akademik me titullin Doktor, që ka disa vite në mësimdhënie i humbet për shumë vite e drejta për të aplikuar për As. Prof., vetëm për shkak të këtij kufizimi pa asnjë lloj justifikimi.
3. Kërkojmë me forcë vendosjen e kriterëve të ndryshme për fitimin e titujve shkencore, për punonjësit kërkimorë dhe ata mesimorë. Duhet të ketë dallime midis këtyre dy kategorive, sa kohë që pjesëmarrja e tyre ne aktivitetin kërkimor apo shkencor (e percaktuar në ligj) është e ndryshme. Këto dallime nuk figurojnë në këtë ligj.

## IV.

**Në Nenin 82, Studimet e doktoratës, pika 5, thuhet “Drejtuesit Shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe**

mund të udhëheqin, respektivisht, **jo më shumë se pesë** dhe **jo më shumë se tre** doktorantë në të njëjtën kohë.

Mendojmë që Prof. dhe As. Prof të udhëheqi jo më shumë se 3 doktoratura në të njëjtën kohë.

**V.**

**Ne Nenin 144, thuhet:**

**1. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton kriteret që duhet të përmbushë kandidati për fitimin e gradës shkencore “Doktor i Shkencave”, sipas përcaktimeve të nenit 76 të këtij ligji, si dhe standardet për fitimin e titullit akademik “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”.**

Të merren në konsideratë vërejtjet dhe komentet e grupeve të interesit përpara se të miratohen kriteret e reja të fitimit të titujve akademike. Duhet të ketë kritere të ndryshme për personel kërkimor shkencor dhe mësitor.

2. Fitimi i titujve akademikë sipas përcaktimeve të këtij ligji bëhet **jo më herët se një vit** nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Të përcaktohet qartë data kufi deri kur pranohen kërkesat për marrjen e titujve sipas kriterëve të ligjit aktual.

**VI.**

**Në Nenin 62, Kategoritë e personelit akademik, pika 6, thuhet:**

**6. Ndhmës-lektor është personeli akademik** që mban gradën shkencore “Doktor”, i punësuar për herë të parë në institucionin e arsimit të lartë si dhe personeli akademik pa gradë shkencore. Ai ka përfunduar së paku programin e studimit “Master i Shkencave”. Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik në Kolegjet profesionale. Ndhmës-lektori punësohet me kontratë me kohë të plotë ose të pjesëshme dhe me kohëzgjatje të caktuar.

Nuk jemi dakort me këtë pikë që konsideron si ndhmës lektorë dhe personelin akademik me gradën Doktor, duke e barazuar atë me një student që sapo ka mbaruar fakultetin. Ndërkohë që marrja e statusit Lektor nga ana e personelit akademik me titull Doktor, nuk kërkon asnjë lloj kualifikimi

shkencor por thjesht një propozim nga drejtuesi i njësisë baze. (kriteret këto të përcaktuara nga ky ligj)

## **VII.**

### **Ne Nenin 120, Granti i punës kërkimore-shkencore, pika 3, thuhet:**

3. Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie bëhet nga AKKSH, mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin, sipas kriterëve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

Propozohet që çdo institucion të ketë përfaqësues në AKKSH, për vlerësimin sa më të saktë të projekteve.